



Vaksina kundër COVID-19

për njerëzit me një sistem imuniteti të dobët

Njerëzit që kanë një sistem imuniteti mjaft të dobët, këshillohen të marrin një dozë të tretë të vaksinës kundër COVID-19. Kjo është për të ndihmuar në përmirësimin e çdo mbrojtjeje që mund të keni krijuar nga 2 dozat tuaja të para dhe jepet përpara dozave tuaja përforcuese.

Çfarë është COVID-19 apo koronavirusi?

COVID-19 është një sëmundje shumë infektive e frymëmarrjes që shkaktohet nga virusi SARS-CoV-2. Mund të jetë shumë serioze te njerëzit që kanë një sistem imuniteti të dobët. Nuk ka kurë për COVID-19, edhe pse disa trajtime të reja të testuara ndihmojnë në uljen e rrezikut të ndërlikimeve.

Pse po më ofrohet një dozë e tretë e vaksinës së COVID-19?

Kjo dozë e tretë u ofrohet të gjithë atyre të moshës 5 vjeç e lart, të cilët kishin një sistem imuniteti të dobët rreth kohës kur morën 2 dozat e para të vaksinës së COVID-19. Është e mundur që ju të mos keni pasur një reagim si njerëzit e tjerë. Kjo dozë e tretë mund të ndihmojë në përmirësimin e reagimit tuaj imunitar dhe t'ju japë mbrojtje më të mirë.

Specialisti juaj mund t'ju këshillojë nëse kjo vlen për ju. Duke marrë dozën e tretë, ju mund të zvogëloni mundësinë për t'u prekur nga infeksioni i COVID-19.

Dhe nëse e bëni këtë, simptomat mund të jenë më të lehta dhe sëmundja mund të jetë më e shkurtër, sesa po të mos e kishit bërë vaksinimin e tretë.

Njerëzit që kanë nevojë për një dozë të tretë janë ata që kishin një sistem imuniteti mjaft të dobët gjatë kohës kur morën 2 dozat e para. Kjo përfshin ata që kishin ose kanë:

- kanceret e gjakut (të tilla si leucemia ose limfoma)
- imunitet të ulur për shkak të mjekimit (të tilla si ilaçe steroide, terapi biologjike, kimioterapi ose radioterapi)
- imunitet të ulur për shkak të çrregullimeve të trashëguara të sistemit imunitar
- një transplant organi ose të palcës kockore
- sëmundje që prekin sistemin imunitar si HIV i keq kontrolluar
- sëmundje ose mjekime të tjera të këshilluara nga specialisti juaj

Kur duhet ta marr një dozë të tretë?

Do t'ju duhet 1 dozë shtesë për të përmirësuar mbrojtjen tuaj. Doza juaj shtesë (e tretë) duhet të jepet të paktën 8 javë pas dozës së dytë.

Pas kësaj, mund t'ju duhet gjithashtu të merrni doza përforsuese për të zgjatur mbrojtjen tuaj - çdo përforsues duhet të jepet pas 3 muajve pas dozës suaj shtesë (të tretë).

Efektet anësore

Efektet anësore shumë të zakonshme përfshijnë:

- ndjesi të dhimbshme, të rëndë dhe butësi në krahun ku keni bërë injeksionin. Kjo ka tendencë të jetë më e përkeqësuar rreth 1 deri në 2 ditë pas vaksinimit
- ndjesi lodhjeje
- dhimbje koke
- dhimbje të përgjithshme ose simptoma të lehta të ngjashme me gripin

Ju mund të pushoni dhe të merrni paracetamol (ndiqni këshillën e dozës në paketim) për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë. Megjithatë ndjesia e temperaturës nuk është e pazakontë për 2 deri në 3 ditë, një temperaturë e lartë është e pazakontë dhe mund të tregojë se keni COVID-19 ose një infektion tjetër.

Simptomat pas vaksinimit zakonisht zgjasin më pak se një javë. Nëse simptomat tuaja duket se përkeqësohen, ose nëse jeni të shqetësuar, mund të telefononi Shërbimin Shëndetësor Kombëtar NHS 111.

Si ta bëni vaksinimin?

Për dozën tuaj të tretë, mund të rezervoni në internet ose të shkoni në një klinikë pa caktuar orar më parë. Për ta ndihmuar klinikën të kontrollojë nëse jeni i përshtatshëm, ju lutemi sillni ndonjë letër nga mjeku juaj i përgjithshëm ose nga specialisti, apo detaje të mjekimit që po merrni.

Personat që nuk duhet ta bëjnë vaksinimin e tretë.

Nëse keni pasur një reagim shumë të rëndë ndaj një doze të mëparshme të vaksinës, duhet ta diskutoni këtë me mjekun tuaj.

Nëse keni humbur një vaksinim.

Nëse nuk e keni marrë ende asnjëherë nga 2 dozat e para të vaksinës, duhet t'i bëni ato sa më shpejt që të jetë e mundur.

Nëse tani kanë kaluar më shumë se 8 javë nga doza juaj e dytë, ju lutemi organizoni marrjen e dozës suaj shtesë (të tretë) sa më shpejt të jetë e mundur.

Nëse jeni 12 vjeç ose më shumë, do t'ju duhet gjithashtu një përforsues. Përforsuesi juaj duhet të jepet pas 3 muajve pas dozës së tretë.

Nëse tashmë e keni marrë përforsuesin tuaj, do të keni të drejtë edhe për një përforsues tjetër këtë pranverë.

Nëse jo, atëherë mund ta merrni përforsuesin tuaj së shpejti, si pjesë e fushatës së pranverës.

Ndoshta do t'ju duhet një përforsues tjetër këtë vjeshtë.



Informacione të mëtejshme

www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/coronavirus-vaccination/

dhe mund të lexoni se çfarë duhet të prisni pas vaksinimit tuaj kundër COVID-19 këtu www.gov.uk/government/publications/covid-19-vaccination-what-to-expect-after-vaccination

© Crown copyright 2021. UK Health Security Agency gateway number: 20211341.

Product code: C22WIZAL Albanian. 500K 2p MAR 2022 (APS). Version 3. 02/03/2022. If you want to order more copies of this leaflet using the product code C22WIZAL Albanian, please visit: www.healthpublications.gov.uk